



Të sapoardhurit me fëmijë të moshës së obligimit shkollor

Të gjithë fëmijët dhe të rinjtë e moshës së obligimit shkollor, që vendosen për banim në ndonjë komunë të Kantonit të Cyrihut, kanë të drejtën dhe obligimin e ndjekjes së shkollës. Ky obligim nis që me fillimin e qëndrimit Tuaj dhe atë pavarësisht nga statusi Juaj i qëndrimit. Në obligimin shkollor bën pjesë edhe kopshti i fëmijëve.

Obligimi shkollor

Obligimi shkollor zgjat njëmbëdhjetë vjet; por, më së largu deri në përfundimin e shkollës popullore. Obligimi shkollor mund të arrihet edhe në shkollat private, të cilat kanë leje për këtë nga Kantoni..

Fëmijët, që kanë mbushur katër vjet¹, përfshihen që nga viti tjetër shkollor në moshën e obligimit shkollor dhe kështu fillojnë me ndjekjen e kopshtit të fëmijëve. Si datë kufitare e datëlindjes merret 31 korriku. Të rinjtë, të cilët kanë mbushur 16 vjet, lirohen nga obligimi shkollor në Kantonin e Cyrihut. Megjithatë, ata kanë të drejtën ta përfundojnë vitin shkollor.

Në shkollën publike popullore nuk ekziston e drejta e zgjedhjes së lirë të shkollës. Fëmijët ndjekin shkollën aty ku banojnë. Organi lokal shkollor (Komisioni Shkollor) i cakton fëmijët në shkolla të caktuara. Prindërit janë të lirë në zgjedhjen e ndonjë shkolle private. Shpenzimet e shkollimit privat i marrin përsipër vetë prindërit.

Lajmërimi i fëmijëve

Nëse një fëmijë është vendosur për banim në ndonjë komunë të Kantonit të Cyrihut, ai duhet të lajmërohet menjëherë nga prindërit në Komisionin Shkollor («Schulpflege»). Ky obligim vlen për të gjithë fëmijët dhe të rinjtë e moshës së obligimit shkollor.

Porsa një familje të jetë vendosur për banim në Kantonin e Cyrihut, prindërit kontaktojnë Komisionin Shkollor («Schulpflege») për të sqaruar fillimin e shkollimit të fëmijës së tyre dhe për të qartësuar pyetjet në lidhje me këtë çështje.

¹ Shembull
Datëlindja mes ...

1.8.2019	dhe	31.7.2020	→	Fillimi i shkollimit në vitin shkollor 2024/25
1.8.2020	und	31.7.2021	→	Fillimi i shkollimit në vitin shkollor 2025/26



Adresat e autoriteteve lokale shkollor i gjeni këtu:

- në tërë kantonin:
www.zh.ch/schulen
- në qytetin e Cyrihut:
https://www.stadt-zuerich.ch/ssd/de/index/volksschule/schulkreise_kreisschulbehoerden.html

Hyrja në shkollë

Komisioni Shkollor («Schulpflege») e cakton fëmijën për të vijuar mësimin në ndonjë prej shkollave Drejtoria e shkollës është përgjegjëse për atë që fëmijën ta vendosë në një klasë të përshtatshme. Klasa duhet t'i përgjigjet mundësisht moshës së fëmijës. Nëse fëmija nuk flet apo flet pak gjermanisht, ai, përveç mësimin të rregullt, ndjek edhe mësimin e gjermanishtes si gjuhë e dytë (DAZ). Mësuesi i klasës së rregullt e përkrah fëmijën në integrim dhe në përpunimin e materies mësimore që zhvillohet në klasë.

Në qytete ekzistojnë pjesërisht edhe «Klasat pranuese» («Aufnahmeklassen»). Në këto klasa fëmijët qëndrojnë maksimalisht një vit. Ata aty mësojnë gjermanishten dhe përgatiten për kalim në klasë të rregullt.

Përgatitja për botën profesionale

Enti për të Rinj dhe Këshillim Profesional ofron këshillime dhe informacione, të cilat lidhen në mënyrë specifike me prindërit me gjuhë të huaj amtare.

Oferta quhet „Integras“.

Për të rinjtë me gjuhë të huaj amtare, të cilët shpërngulen mes moshës 15 deri 21 vjeçare, shkollat për zgjedhjen e profesionit ofrojnë një “Vit për përgatitje profesionale dhe integrim”. Në këtë kurs vjetor të rinjtë mësojnë, para së gjithash, gjermanisht. Veç kësaj, ata fitojnë njohuri, që të mund ta përcjellin ndonjë shkollë tjetër më të avancuar apo të bëjnë shkollim profesional.

Enti për Shkollim të Mesëm dhe Profesional ofron oferta ndërlidhëse. Këto kurse e ndërlidhin kohën mes shkollës obliguese dhe të arsimimit të parë. Kjo ofertë ju dedikohet të rinjve, të cilët pas përfundimit të shkollës sekondare nuk kanë gjetur vend për mësimin e zanatit ose për të cilët është ende herët futja në botën profesionale.



Informacione të tjera për prindërit

- Informata për prindërit mbi shkollën popullore të Kantonit të Cyrihut përfshirë kopshtin e fëmijëve.
- Mësimi i gjermanishtes si gjuhë e dytë
- Ndjekja e mësimit vullnetar në një gjuhë amtare jo gjermane
- Vështrim i përgjithshëm i të gjitha niveleve të sistemit arsimor të Kantonit të Cyrihut
- Lista me linqe për emigrantet dhe emigrantët për integrim, arsim dhe punë